

**IFLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:**  
**Informacion për përdoruesin**

# LEVOSMART

## Tableta të veshura me film – 500 mg (Levofloksacin hemihidrat)

**Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit sepse përmban informacion të rëndësishëm për ju.**

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përkshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në rast se ju shfaqet ndonjë prej efekteve anësore, njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj. Kjo përfshin edhe efekte anësore që nuk janë përmendur në këtë fletëudhëzues.

**Në këtë fletëudhëzues:**

- Çfarë është Levosmart dhe përse përdoret
- Përpara se të merrni Levosmart
- Si ta merrni Levosmart
- Efekte anësore të mundshme
- Si ta ruani Levosmart
- Pëmbajtja e paketimit dhe të dhëna të tjera

#### 1. ÇFARË ËSHTË LEVOSMART DHE PËRSE PËRDORET

Tabletat e veshura me film Levosmart përmbajnë lëndën aktive që quhet levofloksacin. Kjo bën pjesë në një grup barnash të njohur si antibiotikë. Levofloksacin është një antibiotik i klasës së kinoloneve. Ajo vepron duke eliminuar bakteret të cilët janë shkaktarë të infeksioneve në trupin tuaj.

**Levosmart indikohet për trajtimin e infeksioneve të:**

- sinuseve;
- mushkërive, tek njerëzit që vuajnë nga probleme afatgjata të frymëmarrjes ose nga pneumonia;
- traktit urinar, duke përfshirë veshkat ose fshikëzën e urinës;
- gjendrës së prostatës, kur ju vuani nga një infektion afatgjatë;
- lëkurës dhe indeve nën lëkurë, përfshirë muskujt; këto njihen si "indet e buta".

Në disa raste të veçanta, Levosmart mund të përdoret për të pakësuar mundësitë e marrjes së një sëmundjeje pulmonare të quajtur antraks ose përkeqësimit të sëmundjes pasi ju jeni ekspozuar ndaj baktereve që shkaktojnë antraks.

#### 2. PËRPARA SE TË MERRNI LEVOSMART

**Mos e merrni këtë bar dhe lajmëroni mjekun tuaj në qoftë se:**

- jeni alergjik ndaj levofloksacinës ose antibiotikëve të tjerë të klasës së kinoloneve, si: moksifloksacina, ciprofloksacina, ofloksacina ose ndonjë nga eksipientët e këtij bari (përmendur në paragrafin 6); shenjat e një reaksioni alergjik përfshijnë: rash, vështirësi në qëllitje ose probleme në frymëmarrje, enjtje të buzëve, fytyrës, fytyt ose gjuhës;
- vuani nga epilepsia;
- jeni patur ndonjëherë probleme të tendineve si p.sh. tendinit, i lidhur me trajtimin me një 'antibiotik kinolinik'; tendini është një fije që lidh muskulin me skeletin tuaj;
- jeni fëmijë ose adoleshent;
- jeni shtatzënë, mendoni se jeni shtatzënë ose planifikoni një shtatzëni;
- ushqeni foshnjen me gji.

Në qoftë se mendoni se keni ndonjë nga gjendjet e përmendura më sipër, mos e merrni këtë bar. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj përpara se të merrni Levosmart.

**Tregoni kujdes të veçantë me Levosmart**

**Përpara se të merrni këtë bar:**

Nuk duhet të merrni antibiotikerialë të grupit të fluorokinoloneve / kinoloneve, përfshirë Levosmart, nëse keni patur më parë ndonjë efekt anësor të rëndë pas marrjes së tyre. Në një situatë të tillë, informoni mjekun sa më parë.

**Kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj nëse:**

- jeni 60 vjeç ose më shumë;
- jeni duke përdorur kortikosteroidë, shpesh të quajtur steroide (shih paragrafin "Marrja e barnave të tjera");
- keni kaluar kriza (konvulsione);
- keni patur dëmtime në tru për shkak të një insulti ose dëmtime të tjera të trurit;
- keni probleme të veshkave;
- vuani nga ajo që njihet si "mungesë e enzimës glukozë - 6 – fosfat dehidrogjenazë"; ju keni më shumë gjasa për të patur probleme serioze të gjakut nëse merrni këtë bar;
- keni patur probleme të shëndetit mendor;
- keni patur probleme të zemrës: kujdes duhet treguar kur përdorni këtë bar nëse keni lindur me, ose keni histori familjare të intervalit QT të zgjatur (i parë në EKG, regjistrimi elektrik i zemrës), keni disbalancë të kripës në gjak (veçanërisht nivele të ulta të kaliumit ose magnezit në gjak), keni ritëm të ulët të zemrës (i quajtur "bradikardi"), keni një zemër të dobët (insuficiencë kardiake), keni një histori ataku kardiak (infarkt miokardi), jeni femër ose person i moshuar ose jeni duke marrë barna të tjera që shkaktojnë ndryshime jonormale në EKG (shih paragrafin "Marrja e barnave të tjera");
- jeni pacient diabetik;
- keni miasteni gravis;
- jeni diagnostikuar me zmadhim ose "fryrje" të një ene të madhe gjaku (aneurizëm i aortës ose aneurizëm periferik i një ene të madhe periferike gjaku);
- ju ka ndodhur më parë episod i çarjes së aortës (çarje në murin e saj);
- jeni diagnostikuar me rrjedhje nga valvulat e zemrës (regurgitim të valvulave të zemrës)
- keni histori familjare të aneurizmit të aortës apo çarjes së saj ose faktorë të tjerë risku apo situata predispozuese (p.sh. çrregullime të indit lidhor si sindroma Marfan, ose sindroma Ehlers – Danlos, sindroma Turner, sindroma Sjögren [një sëmundje inflamatore autoimmune], ose çrregullime vaskulare si artrit Takayasu, artrit me qelizë gigande, sëmundjen Behçet, presion të lartë gjaku ose ateriosklerozë të njohur, artrit reumatoid [një sëmundje e artikulacioneve] ose endokardit [një infeksion i zemrës]).
- nëse kaluar ndonjëherë një rash të rëndë të lëkurës apo rrjepje të lëkurës, fluska dhe/ose ulçera në gojë pasi keni marrë levofloksacin.

- jeni pacient diabetik;
- keni patur probleme me mëlcinë;
- keni miasteni gravis;
- jeni diagnostikuar me zmadhim ose "fryrje" të një ene të madhe gjaku (aneurizëm i aortës ose aneurizëm periferik i një ene të madhe periferike gjaku);
- ju ka ndodhur më parë episod i çarjes së aortës (çarje në murin e saj);
- jeni diagnostikuar me rrjedhje nga valvulat e zemrës (regurgitim të valvulave të zemrës)
- keni histori familjare të aneurizmit të aortës apo çarjes së saj ose faktorë të tjerë risku apo situata predispozuese (p.sh. çrregullime të indit lidhor si sindroma Marfan, ose sindroma Ehlers – Danlos, sindroma Turner, sindroma Sjögren [një sëmundje inflamatore autoimmune], ose çrregullime vaskulare si artrit Takayasu, artrit me qelizë gigande, sëmundjen Behçet, presion të lartë gjaku ose ateriosklerozë të njohur, artrit reumatoid [një sëmundje e artikulacioneve] ose endokardit [një infeksion i zemrës]).
- nëse kaluar ndonjëherë një rash të rëndë të lëkurës apo rrjepje të lëkurës, fluska dhe/ose ulçera në gojë pasi keni marrë levofloksacin.

Reaksione serioze në lëkurë
Nga marrja e levofloksacin janë raportuar reaksione serioze të lëkurës duke përfshirë sindromin Stevens-Johnson (SJS), nekrolizë epidermale toksike (TEN) dhe reaktion ndaj barit me eozinofili dhe simptoma sistemike (DRESS).

- SJS/TEN mund të shfaqen fillimisht si njolla rumbullake apo rrethore të kuqe, shpesh me fluska qendrore në trung. Gjithashtu mund të shfaqen ulçeracione të gojës, hundës, organeve gjenitale dhe syve (sy të kuq dhe të enjtur). Këto raste serioze të lëkurës shpesh paraprihen nga temperatura dhe / ose simptoma të ngjashme me gripin. Rashet mund të avancojnë në rrjepje të përhapur të lëkurës dhe në komplikacione kërcënuese për jetën ose mund të jenë fatale.
- DRESS fillimisht shfaqet me simptoma të ngjashme me gripin dhe rash në lëkurë, me temperaturë të lartë trupore; në analizat e gjakut vërehen nivele të rritura të enzimave të mëlcisë dhe një rritje e një tipi të qelizave të bardha të gjakut (eozinofili) dhe gjendra limfatike të zmadhuara.

Nëse ju shfaqet rash serioz ose ndonjë nga këto simptoma të tjera në lëkurë, ndërpriteni marrjen e levofloksacin dhe kontaktoni mjekun tuaj ose kërkoni menjëherë ndihmën mjekësore.

Nëse nuk jeni i sigurt nëse ndonjëra nga gjendjet e mësipërme ju përket, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj përpara se të merrni Levosmart.

**Ndërkohë që merrni këtë bar**

Dhimbje dhe enjtje e kyçeve dhe inflamacion ose këputje e tendineve mund të shfaqet rrallë. Risku është më i lartë në qoftë se jeni i moshuar (mbi 60 vjeç), keni marrë organ të transplantuar, keni probleme me veshkat apo jeni duke u trajtuar me kortikosteroidë. Mund të ndodhë inflamacion ose këputje e tendineve brenda 48 orëve të para të trajtimit ose deri në disa muaj pas ndërprerjes së terapisë me Levosmart. Ndaloni marrjen e Levosmart që në shfaqjen e parë të ndonjë dhimbjeje ose inflamacioni të tendineve (p.sh. në thembër, kyçin e dorës, bërryl, shpatull ose gju), flisni me mjekun dhe mbani në qetësi zonën e dhimbshme. Shmangni çdo sforcim të panevojshëm, sepse mund të risë rrezikun e këputjes së tendinit.

Ju mund të përjetoni rrallë simptoma të dëmtimit të nervave (neuropatisë) të tilla si: dhimbje, djegie, therje, mpirje dhe / ose dobësi, veçanërisht në gjatësinë e këmbës, pjesën e poshtme të saj, në krahe dhe gjunjë. Në qoftë se ndodh kjo, ndaloni marrjen e Levosmart dhe njoftoni menjëherë mjekun për të parandaluar zhvillimin e një gjendjeje të parikthyeshme.

- Nëse keni dhimbje të forta, të papritura, në bark, kraharor apo kurriz, të cilat mund të jenë simptoma të aneurizmit dhe çarjes së aortës, shikoni menjëherë në urgjencë. Rreziku është më i lartë nëse po trajtoheni me kortikosteroidë.
- Nëse menjëherë filloni të ndjeni marrje fryme, veçanërisht kur shtriheni me kurriz, apo vëreni enjtë të kaviljeve, këmbëve apo abdomenit, apo një shfaqje të re të palpitacioneve të zemrës (ndjesi të rrahjes së shpejtë apo të çrregullt të zemrës), duhet të lajmëroni mjekun menjëherë.

**Efekte anësore serioze, të zgjatura, gjymtuese dhe potencialisht të pakthyeshme**
Antibakterialet e grupit të fluorokinoloneve / kinoloneve, përfshirë levofloksacinën, janë shoqëruar me efekte anësore shumë të rralla, por serioze, disa prej të cilëve të zgjatur në kohë (kanë vazhduar muaj ose vite), gjymtuese ose potencialisht të pakthyeshme. Këtu përfshihen: dhimbje e tendineve, muskujve dhe kyçeve të gjymtyrëve të sipërme dhe të poshtme, vështirësi në ecje, ndjesi jonormale si ndjesi shpimi gjilpërash, therje, guduljsje, mpirje ose djegie (parestezi), çrregullime të shqisave përfshirë dëmtimin e pamjes, shijes, nuhatjes, dëgjimit, depresion, dëmtime të kujtesës, këputje e theksuar dhe çrregullime të rënda të gjumit.

Nëse ju shfaqet ndonjë nga këto efekte pas marrjes së Levosmart, njoftoni menjëherë mjekun përpara se të vazhdoni trajtimin. Bashkë me të do të vendosni mbi vazhdimësinë e trajtimit, duke marrë në konsideratë edhe antibiotikë nga klasa të tjera.

**Marrja e barnave të tjera**

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë, keni marrë së fundmi ose mund të merrni barna të tjera, duke përfshirë edhe ato pa recetat. Levosmart mund të ndikojë në mënyrën e veprimit të disa barnave. Gjithashtu disa barna mund të ndikojnë në mënyrën e veprimit të Levosmart.

**Në veçanti, tregojini mjekut në rast se jeni duke marrë ndonjë nga këto barna. Kjo për shkak se mund të rritet mundësia për shfaqjen e efekteve anësore kur këto barna merren me Levosmart:**

- kortikosteroidët, të njohur edhe si steroide – barna që përdoren për të trajtuar inflamacionin; ju mund të jeni më i rrezikuar nga inflamacioni dhe/ose këputja e tendineve;
- varfarina – e përdorur për hollimin e gjakut; ju mund të jeni më i prirur për të patur gjakrrjedhje; mjeku juaj mund të ketë nevojë për analiza të rregullta të gjakut për të parë aftësinë e gjakut për tu mpiksur;
- teofilina – e përdorur për problemet e frymëmarrjes; ju jeni më i prirur për të shfaqur konvulsione nëse përdorni Levosmart;
- anti - inflamatorët josteroidikë (AJS) – të përdorur për trajtimin e dhimbjes dhe inflamacionit, si: aspirina, ibuprofeni, fenbufeni, ketoprofeni dhe indometacina; ju jeni më i prirur për të shfaqur konvulsione nëse përdorni Levosmart;
- ciklosporina – e cila përdoret pas transplantit të organeve; mund të rritet mundësia për efektet anësore të ciklosporinës;
- barna që mund të çrregullojnë ritmin e zemrës; këtu përfshihen barnat që përdoren për çrregullime të rrahjeve të zemrës (antiaritmikët si p.sh.: kinidinë, hidrokinidinë, disopiramid, sotalol, dofetilid, ibutilid dhe amiodaron), për depresion (antidepressivët trciklikë si p.sh. amitriptilinë dhe imipraminë), për sëmundjet psikiatrike (antipsikotikët), dhe për infeksione bakteriale (antibiotikët që bëjnë pjesë në klasën e 'makrolidëve' si p.sh. eritromicina, azitromicina dhe klarmtromicina);
- probenecid – që përdoret për trajtimin e gutës dhe cimetidinë – që përdoret për të trajtuar ulçerën dhe urthin; mjeku juaj mund t'ju reduktojë dozën nëse keni probleme me veshkat;
- cimetidine – që përdoret për dhimbjet dhe ulçerat e stomakut. Doktori mund t'ju përkshruajë një dozë më të ulët, nëse vuani nga dëmtime renale.

**Mos merrni Levosmart në të njëjtën kohë me barnat e mëposhtme. Kjo për shkak se mund të ndikojnë në mënyrën e veprimit të saj:**

- tableta të hekurit (për trajtimin e anemisë), suplemente të zinkut, antiacide që përmbajnë magnez ose alumin (për aciditetin ose urthin), didanozinë ose sukralfat (për ulçerat e stomakut). Shih paragrafin 3 "Si ta merrni Levosmart".

**Testet e urinës për opiatet**

Testet e urinës mund të tregojnë rezultate "falls pozitive" për qetësuesit e fortë të quajtur "opiate" në njerëz që marrin Levosmart. Nëse mjeku ju ka caktuar të bëni një test urine, tregojini mjekut tuaj që jeni duke marrë Levosmart.

**Testet e tuberkulozit**

Ky bar mund të shkaktojë rezultate "falls negative" për disa teste laboratorike që përdoren për të kërkuar bakteret që shkaktojnë tuberkulozin.

**Shtatzënia dhe ushqyerja me gji**

Mos e përdorni këtë bar nëse:

- jeni shtatzënë, mendoni se jeni shtatzënë, ose planifikoni një shtatzëni;
- jeni duke ushqyer fëmijën me qumështin e gjirit ose e keni në plan diçka të tillë.

**Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive**

Ju mund të keni disa efekte të padëshiruara pas marrjes së këtij bari, të tilla si: marrje mendsh, përgjumje, çrregullime të ekuilibrit (vertigo) ose ndryshime të të parit. Disa prej këtyre efekteve të padëshiruara mund të dëmtojnë aftësinë për tu përqëndruar dhe reaguar. Nëse ndodh diçka e tillë, mos drejtoni automjete dhe mos ndërmerrni punë që kërkojnë nivel përqëndrimi të lartë.

#### 3. SI TA MERRNI LEVOSMART

Ky bar duhet të përdoret gjithmonë ekzakhtësisht sipas këshillës së mjekut. Në rast se nuk jeni të sigurt, këshillohuni me mjekun ose farmacistin. Tableta mund të merret së bashku me ushqimin ose në çdo kohë ndërmjet vakteve ushqimore.

**Në rast se ndërkohë jeni duke marrë tableta që përmbajnë hekur, suplemente zinku, antiacidë, didanozinë ose sukralfat,** mos i merrni këto barna në të njëjtën kohë me Levosmart. Merrni ato të paktën 2 orë para ose pas marrjes së Levosmart.

Doza varet nga loji i infeksionit që keni dhe vendi ku ai ndodhet në tru. Kohëzgjatja e trajtimit varet nga fakti sa i rëndë është infeksioni. Nëse ndjeni që efekti i këtij bari është shumë i fortë ose shumë i dobët, mos e ndryshoni dozën, por pyesni mjekun tuaj.

**Të rriturit dhe të moshuarit**

**Infeksione të sinuseve**

- një tabletë Levosmart 500 mg, një herë në ditë.

**Infeksione të mushkërive tek njerëzit që vuajnë nga probleme afatgjata të frymëmarrjes**

- një tabletë Levosmart 500 mg, një herë në ditë.

**Pneumoni**

- një tabletë Levosmart 500 mg, një herë ose dy herë në ditë.

**Infeksione të traktit urinar, duke përfshirë veshkat ose fshikëzën e urinës**

- ½ ose një tabletë Levosmart 500 mg, në ditë.

**Infeksione të gjendrës së prostatës**

- një tabletë Levosmart 500 mg, një herë në ditë.

**Infeksione të lëkurës dhe indeve nën lëkurë, përfshirë muskujt**

- një tabletë Levosmart 500 mg, një herë ose dy herë në ditë.

**Të rriturit dhe të moshuarit me probleme të veshkave**

Mjeku juaj mund t'ju përkshruajë një dozë më të vogël.

**Fëmijët dhe adoleshentët**

Ky bar nuk duhet të merret nga fëmijët ose adoleshentët.

**Mbroni lëkurën nga ekspozimi ndaj dritës së diellit**

Në rast se aksidentalisht merrni më shumë tableta nga sa duhet, këshillohuni menjëherë me mjekun ose kërkoni ndihmën mjekësore. Merrni me vete tabletat dhe kufinë e tyre. Kështu mjeku do ta dijë çfarë keni marrë. Simptomat e mëposhtme mund të shfaqen: kriza konvulsive (konvulsione), konfuzion, marrje mendsh, pavetëdije, prani e dridhjeve, probleme të zemrës që çojnë në çrregullime të rrahjeve të zemrës si dhe të përziera ose djegie në stomak.

**Në qoftë se keni marrë më shumë Levosmart**

Në rast se aksidentalisht merrni më shumë tableta nga sa duhet, këshillohuni menjëherë me mjekun ose kërkoni ndihmën mjekësore. Merrni me vete tabletat dhe kufinë e tyre. Kështu mjeku do ta dijë çfarë keni marrë. Simptomat e mëposhtme mund të shfaqen: kriza konvulsive (konvulsione), konfuzion, marrje mendsh, pavetëdije, prani e dridhjeve, probleme të zemrës që çojnë në çrregullime të rrahjeve të zemrës si dhe të përziera ose djegie në stomak.

**Në qoftë se harroni të merrni Levosmart**

Në qoftë se harroni të merrni një dozë, merrni atë sapo të kujtoheni, me kusht që doza tjetër të mos jetë afër. Mos merrni një dozë të dyfishtë për të plotësuar dozën e harruar.

**Në qoftë se ndërprisni trajtimin me Levosmart**

Mos e ndërprisni marrjen e Levosmart vetëm sepse ndiheni mirë. Është e rëndësishme që të përfundoni ciklin e trajtimit ashtu siç e ka përkshruar mjeku. Në rast se e ndërprisni trajtimin para kohës së duhur, infeksioni mund të rikthehet, gjendja juaj mund të përkeqësohet ose bakteri mund të bëhet rezistent ndaj barit. Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij bari, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

#### 4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat, edhe ky bar mund të shkaktojë efekte anësore, ndonëse ato nuk shfaqen tek të gjithë. Këto efekte janë zakonisht të lehta ose të moderuara dhe shpesh zhduken me kalimin e kohës.

**Ndërprisni marrjen e Levosmart dhe këshillohuni menjëherë me mjekun ose shikoni në spital në qoftë se ju shfaqet ndonjë prej efekteve anësore të mëposhtme:**

**Shumë të rralla** (më rrallë se 1 në 10,000 persona)

- keni një reaksion alergjik. Shenjat mund të përfshijnë: rash, vështirësi në frymëmarrje ose në qëllitje, enjtje të buzëve, fytyrës, gjuhës ose fytyt.

**Ndërprisni marrjen e Levosmart dhe këshillohuni menjëherë me mjekun në qoftë se ju shfaqet ndonjë prej efekteve anësore serioze të mëposhtme, sepse mund të keni nevojë për trajtim mjekësor urgent:**

**Të rralla** (më rrallë se 1 në 1,000 persona):

- diarre e ujshme e cila mund të ketë prani gjaku, mundësisht me dhimbje stomaku dhe temperaturë të lartë; këto mund të jenë shenja të një problemi të rëndë të zorrës;
- dhimbje dhe inflamacion i tendineve ose ligamenteve, që mund të çojë deri në këputje; tendini i Aklilit preket më shpesh;
- kriza (konvulsione);
- shikimi ose dëgjimi i gjërave që nuk ekzistojnë (haluçinacione, paranoja), ndryshim i opinioneve dhe mendimeve (reaksione psikotike), duke përfshirë risqe për mendime apo veprime për të vrarë veten;
- ndjenjë depresioni, probleme mendore, ndjesi padurimi (nervozizëm), ëndrra jo normale ose mankthe;
- rashe të rënda të lëkurës, duke përfshirë sindromin Stevens-Johnson dhe nekrolizë epidermale toksike; këto mund të shfaqen si njolla rumbullake apo zona rrethore të kuqe, shpesh me fluska qendrore në trung, ulçeracione të gojës, hundës, organeve gjenitale dhe syve dhe mund të paraprihen nga temperatura dhe / ose simptoma të ngjashme me gripin; shikoni paragrafin 2;
- rash i përhapur gjerësisht, temperaturë e lartë trupore, rritje e enzimave të mëlcisë, çrregullime të gjakut (eozinofili), zmadhim i gjendrave limfatike dhe përfshirje e organeve të tjera të trupit (Reaksion ndaj Barit me Eozinofili dhe Simptoma Sistematike, i njohur si DRESS apo sindromi i mbindjeshmërisë ndaj barit); shikoni paragrafin 2;
- sindrom i lidhur me dëmtim të jashtëqitjes së ujit dhe nivele të ulëta të natriumit (SIADH).

**Shumë të rralla** (më rrallë se 1 në 10,000 persona)

- djegje, vështi shpimi, dhimbje ose mpirje. Këto mund të jenë shenja të asaj që quhet 'neuropati'.

**Të tjera:**

- skuqe të rënda të lëkurës të cilat përfshijnë fluskat ose rrjepjen e lëkurës përreth: buzëve, syve, gojës, hundës dhe organeve gjenitale;
- humbje koke, marrje mendsh;
- të përziera, të vjella, diarre;
- rritje e nivelit të disa enzimave të mëlcisë në gjak.

Këto mund të jenë shenja të problemeve të mëlcisë të cilat mund të përfshijnë insuficiencë të rëndë të mëlcisë.

Në rast se shikimi juaj dëmtohet ose nëse keni shqetësime të tjera të syve ndërkohë që jeni duke marrë Levosmart, konsultohuni me një mjek specialist të syve menjëherë.

**Kontaktoni menjëherë me mjekun në rast se ndonjë nga efektet e padëshiruara të mëposhtme bëhet serioz ose zgjat më shumë se disa ditë:**

**Të zakonshme** (prekin më pak se 1 në 10 persona):

- probleme me gjumin;
- dhimbje koke, marrje mendsh;
- të përziera, të vjella, diarre;
- rritje e nivelit të disa enzimave të mëlcisë në gjak.

**Të pazakonta** (prekin më pak se 1 në 100 persona):

- ndryshime të numrit të baktereve ose myqeve, infeksion i shkaktuar nga Candida, që mund të ketë nevojë për trajtim;
- ndryshime të numrit të qelizave të bardha të gjakut të shfaqura në rezultatet e disa prej analizave të gjakut (leukopeni, eozinofili);
- stres (ankth), konfuzion, nervozizëm, përgjumje, dridhje, çrregullim i ekuilibrit (vertigo);

- vështirësi në frymëmarrje (dispne);
- ndryshime në shije, humbje oreksi, shqetësime në stomak ose mostretje (dispepsi), dhimbje në zonën e stomakut, fryrje barku (flatulencë) ose konstipacion;
- kuarje dhe skuqeje e lëkurës, ndjenjë kuarje e ashpër ose urtikarie, djersitje e shtuar (hiperhidrozë);
- dhimbje artikulacionesh ose dhimbje muskujsh;
- vanalizat e gjakut mund të tregojnë rezultate jo të zakonshme për shkak të problemeve të mëlcisë (rritje e bilirubinës) ose veshkës (rritje e kreatininës);
- dobësi e përgjithshme.

**Të rralla** (prekin më pak se 1 në 1,000 persona):

- pakësim i numrit të trombociteve që shoqërohet me shtim të prirjes për mavijosje dhe gjakrrjedhje (trombocitopeni);
- pakësim i numrit të qelizave të bardha të gjakut (neutropeni);
- shtim i përgjigjes imunitare (mbindjeshmëri);
- rënie e theksuar e nivelit të sheqerit në gjak (hipoglicemi); kjo është e rëndësishme për ata persona që vuajnë nga diabeti;
- të parit ose të dëgjuarit e gjërave që nuk janë reale (haluçinacione, paranojë), ndryshim i opinionit dhe mendimeve (reaksione psikotike) me rrezik për mendime ose veprime vetëvrasëse;
- depresion, probleme mendore, gjendje e shqetësuar (axhitim), ëndrra jonormale ose makthe;
- ndjesi shpimi apo therje në duar ose në këmbë (parestezi);
- çrregullime të dëgjimit (tinitus) ose të syve (shikim i paqartë);
- rrahje të shpejta të zemrës (takikardi) ose presion i ulët i gjakut (hipotension);
- dobësim i muskullit; kjo është e rëndësishme në personat me miasteni gravis (çrregullim i rrallë i sistemit nervor);
- çrregullime të funksionit të veshkave dhe me raste insuficiencë renale për shkak të një reaksioni alergjik në veshka i quajtur nefrit intersticial;
- ethe;
- njolla eritematoze të kufizuara qartë me/pa fluska që shfaqen brenda pak orëve pas administrimit të levofloksacinës dhe shërohen me hiperpigmentim rezidual postinflamator; zakonisht gjenden në të njëjtën pjesë të lëkurës ose membranave mukozale pas